Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 321/01
Datë: 29.06.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Kolegji AAB/QGJK"**, me adresë Zona industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, Prishtinë për periudhën 02.06.2017 deri 02.06.2020 për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:

1.1.Parukeri; Niveli IV sipas KKK, me 60 kredi të AAP;
1.2.Estetikë, Niveli IV sipas KKK, me 60 kredi të AAP;
1.3.Grimer, Niveli III sipas KKK, me 20 kredi të AAP;
1.4.Manikyr, Niveli III sipas KKK, me 20 kredi të AAP;
1.5.Pedikyr, Niveli III sipas KKK, me 20 kredi të AAP;
1.6.Trafik Rrugor, Niveli IV sipas KKK, me 60 kredi të AAP;
1.7.Transport Rrugor, Niveli IV sipas KKK, me 60 kredi të AAP.;
1.8.Administrues i rrjetit dhe sigurisë së sistemeve, Niveli V sipas KKK, me 120 kredi të AAP;
1.9.Programer profesionist, Niveli V sipas KKK, me 120 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Parukeri:
   2.1 Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një profesionist në fushën e parukerisë të kualifikuar nga sektori privat).

2.2 Të hartohet testi me pyetje dhe detyra për provimin përfundimtar. Vlerësimi të bëhet me pikë.
2.3 Të trajnohet dhe certifikohet stafi mësimdhënës në drejtim të rregullave të sigurisë dhe shëndetit (ndihma e parë).
2.4 Të pajiset me uniforma të punes stafi/kandidatët me logon e qendrës.
2.5 Të zhvillohet një kontratë marreveshje bashkëpunimi në mes të qendrës dhe kandidatëve.
2.6 Vendosja në qendër e kutisë së ankesave.

3. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Estetikë:
   3.1 Hartim i politikave per zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik.
   3.2 Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një estetist/e të kualifikuar nga sektori privat).
   3.3 Të hartohet katalogu me pyetje dhe detyra për provimin përfundimtar. Vlerësimi të bëhet me pikë dhe jo nota si dhe të përcaktohet pragu i kalueshmërisë.
   3.4 Literatura për çdo modul të jetë e plotësuar në gjuhën shqipe.
   3.5 Të paraqitet planimetria e sallave te praktikës dhe teorisë për modulin Estetikë (pozicionimi me orenditë dhe mjeteve përkatese për numrin e studentëve të parashikuar).
   3.6 Për çdo modul profesional në procesin e mësimdhënies të ketë një ndarje në përqindje të orëve teorike dhe praktike profesionale.
   3.7 Politikat dhe procedurat e sistemit për sigurimin e cilësisë, te perfshihen ne nje dokument te veqante.
   3.8 Te zhvillohen procedurat përkatëse për vlerësim dhe testim formativ dhe sumativ.
   3.9 Ofrimi i deshmisë për vlerësimin e performancës së stafit.

4. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Grimer:
   4.1 Të trajnohet dhe çertifikohet stafi mësimdhënës në këto drejtime:
      - Metodave të didaktikes për mësimdhënie
      - Metodat e dhënies së ndihmës së parë dhe metodat e mbrojtjes nga zjarri.

   4.2 Të përcaktohen: ditët javore të frekuentimit të kandidatit
   4.3 Zhvillimi i çertificates ku të përmbahen elemente informative të qendrës dhe kandidatit:
      - Paraqitja e vlerësimit të bëhet me pike, jo me notë dhe të vendoset pragu i kalueshmërisë i testit praktik me mbi 80 pikë.
      - Të paraqiten kompetencat e përfituara dhe vlerësimi përkatës

4.4 Paraqitja e orëve teorike dhe praktike për secilin modul në programin për Grim.
4.5 Të zhvillohet një rregullore rreth vijueshmërisë së kandidatit për orët ditore dhe shtrirja e afatit kohor të kursit.
4.6 Hartimi i një testi paraprak vlerësues i njohurive të kandidatit në fazën e hyrjes për regjistrim.
4.7 Hartimi i literaturës (paketën mësimore) teoriko- praktike në përputhje me plan-programin që do të implementohet në qendër.

5. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Manikyr:
   5.1 Politikat dhe procedurat e sistemit për sigurimin e cilësisë, të perfshihen në një dokument të veqantë.
   5.2 Të zhvillohen procedurat përkatëse për vlerësim dhe testim formativ dhe sumativ.
   5.3 Hartim i politikave për zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik si dhe çertifikimi i tyre.
   5.4 Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një profesionist në fushën e manikyrit, të kualifikuar nga sektori privat).
   5.5 Të hartohet katalogu me pyetje dhe detyra per provimin përfundimtar. Vlerësimi të bëhet me pikë dhe jo nota.
   5.6 Literatura për çdo modul të jetë e plotësuar në gjuhën shqipe.
   5.7 Të paraqitet plani i sallave të praktikës dhe teorisë për profilin e Manikyrit (pozicionimi me orenditë dhe mjetet përkatëse) për numrin e studentëve të parashikuar.
   5.8 Për çdo modul profesional në procesin e mësimdhënies të ketë një ndarje në përqindje të orëve teorike dhe praktike profesionale.

6. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Pedikyr:
   6.1 Hartimi i literatures (paketën mësimore) teoriko- praktike në përputhje me plan-programin që do të implementohet në qendër.
   6.2 Hartimi i një testi paraprak vlerësues i njohurive të kandidatit në fazën e hyrjes për regjistrim.
   6.3 Të zhvillohet një regullore rreth vijueshmërisë së kandidatit për orët ditore dhe shtrirja e afatit kohor të kursit.
   6.4 Paraqitja e orëve teorike dhe praktike për secilin modul në programin për Pedikyr.
   6.5 Zhvillimi i çertificatës ku të përmbahen elemente informative të qendrës dhe kandidatit.
   6.6 Paraqitja e vlerësimit të bëhet me pikë, jo me notë dhe të vendoset pragu i kalueshmërisë i testit praktik me mbi 80 pikë.
   6.7 Të paraqiten kompetenca të përfituara dhe vlerësimi përkatës
   6.8 Të trajnohet dhe çertifikohet stafi mësimdhënës në këto drejtime:

- Metodave të didaktikes për mësimdhënie
- Metodat e dhënies së ndihmës së parë dhe metodat e mbrojtjes nga zjarri.

6.9 Të ketë një marrëveshje bashkëpunimi në mes qendrës dhe kandidatëve.

6.10 Të paraqiten dëshmi për vlerësimin e performancës së stafit nga ana pedagogjike.

6.11 Të bëhet ndarja e orëve teorike dhe praktike për secilin nga modulet e pedikyrit.

7. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Trafik rrugor:
   - 7.1 Hartimi i politikave dhe procedurave për të gjitha proceset e punës duke filluar nga pragu minimal, kriteret për pranimin të kandidateve për AAB/QGJK dhe rregullore tjera, duke e adaptuar vetëm për Qendrën e trajnimeve dhe të jenë në një dokument të veqantë.
   - 7.2 Zbatimi i politikave për sigurimin e cilësisë se brendshëm(në vijim).
   - 7.3 Zhvillimi i formatit të vlerësimit të kandidatëve sipas moduleve.
   - 7.4 Formati i testeve për vlerësimin e kandidatëve në përqindje për të dy pjesët (teorike dhe praktike) sipas moduleve p.sh. pjesa teorike mbi 51 % dhe pjesa praktike mbi 70 %.
   - 7.5 Hartimi i rregullores për siguri dhe shëndet në punë.
   - 7.6 Zhvillimi i formularëve për raportim të incidenteve.

8. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Transport rrugor:
   - 8.1 Hartimi i politikave dhe procedurave për të gjitha proceset e punës duke filluar nga pragu minimal, kriteret për pranimin të kandidatëve për AAB/QGJK dhe rregullore tjera, duke e adaptuar vetëm për Qendrën e trajnimeve dhe të jenë në një dokument të veqantë.
   - 8.2 Zbatimi i politikave për sigurimin e cilësisë së brendshëm(në vijim).
   - 8.3 Zhvillimi i formatit të vlerësimit të kandidatëve sipas moduleve.
   - 8.4 Formati i testeve për vlerësimin e kandidatëve në përqindje për të dy pjesët (teorike dhe praktike) sipas moduleve p.sh. pjesa teorike mbi 51 % dhe pjesa praktike mbi 70 %.
   - 8.5 Hartimi i rregullores për siguri dhe shëndet në punë.
   - 8.6 Zhvillimi i formularëve për raportim të incidenteve.

9. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Administrues i rrjetit dhe sigurisë së sistemeve:
   - 9.1 Të ofrohen ekzemplarë të testeve të rregullta dhe të projekteve finale për të gjitha lëndët
   - 9.2 Të riorganizohet sinjalizimi duke e shtuar planin e evakuimit në secilën hapësirë të brendshme
   - 9.3 Riorganizimi i laboratorëve të administrimit të serverëve dhe rrjeteve kompjuterike
   - 9.4 Ligjëruesit të mos kenë angazhime trajnimi më shumë se 4 orë në ditë

9.5 Të vendoset kutia e ankesave/sugjerimeve në një hapësirë jo të vëzhguar nga kamerat

10. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin Programer profesionist:

10.1 Në shtojcën për kriteret plotësuese për pranimin e kandidatëve në QGjK dhe në dokumente tjera ka pika dhe kritere që nuk janë në harmoni me njëra tjetrën, siç janë mosha dhe shkollimi, pasi diku thuhet se përfundimi i shkollës së mesme e diku thuhet matura. Rekomandohet që kushtet dhe kriteret e pranimit të kandidatëve të jenë të njëjta dhe të qarta.

10.2 Lëvizshmërisë së kandidatëve i kontribuon njohja dhe transferi i kredive të fituara nga kandidatët në institucione të ndryshme. Rekomandohet që të zhvillohet dhe aprovohet procedurë për mënyrën e njohjes dhe transferit të kredive, të fituara nga kandidatët në institucione të tjera të akredituara.

10.3 Në dokumentet rreth vlerësimit dhe në dokumente tjera nuk është e përcaktuar se deri në sa herë ka të drejtë të hyjë kandidati në modulin e njëjtë apo në testin final. Rekomandohet që të zhvillohet dhe të aprovohet procedurë e shkruar për kushtet dhe mundësitë e ri testimit duke cekur qartë afatet dhe numrin e herëve që kandidati ka të drejtë të hyjë.

10.4 QGjK nuk ka filluar procesin mësimor dhe nuk ka pasur vlerësim të përformancës. Megjithatë për tu kryer ky vlerësim, rekomandohet që të zhvillohen procedura të qarta për vlerësimin e përformancës së stafit për punën që lidhet me QGjK-në.

10.5 Profili është i lidhur ngushtë me punën praktike dhe menaxhmenti ka deklaruar se ka lidhur disa memorandume bashkëpunimi me kompani private dhe publike që merren me zhvillimin e softuerit dhe institucione tjera për të kryer punën praktike. Rekomandohet që këto memorandume të jetë të jenë të plotësuara me shtesa (anekse) ku specifikohen qartë obligimet e të palëve dhe kohëzgjatja të jetë në harmoni me numrin e orëve të përcaktuara për punën në industri.

10.6 Struktura e përgjithshme e moduleve, përshkrimet e tyre dhe lista e mësimdhënësve në disa raste kanë mospërputhje në mes vete, pasi që emrat janë të ndryshëm. Rekomandohet QGjK që të harmonizojë listën e mësimdhënësve nëpër module/programe duke përcaktuar për secilën lëndë obligative dhe zgjedhore edhe mësimdhënësin kryesor apo bartësin e lëndës.

10.7 Meqenëse programi që do të ofrohet është në gjuhen shqipe dhe kërkesat hyrëse nuk e parashohin njohjen e gjuhës angleze, rekomandohet që pjesë të literaturës bazë për të gjitha lëndët të ofrohen edhe në gjuhën shqipe dhe të jetë në dispozicion të kandidatëve.

10.8 QGjK ka paraqitur paketat mësimore për disa nga modulet e kualifikimit. Rekomandohet që të ofrohen paketat mësimore për të gjitha modulet.

10.9 QGjK nuk ka filluar ende punën me kandidat dhe nuk ka të përpiluara ekzemplarë të mundshëm për testet e rregullta dhe projektet finale për secilin modul apo dhe projektin final në fund të kualifikimit. Rekomandohet që të hartohen modelet e ekzemplareve për testet e rregullta dhe projektet finale.

11. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 31.10.2017, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

13. Vendimi u dërgohet:
    - AAB/QGJK;
    - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së